



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK  
DREJTORIA JURIDIKE DHE E MONITORIMIT TË PROCEDURAVE

№ 57 Prot.

Tiranë, më 23/09 /2024

NJOFTIM

**Drejtuar:** Autoriteteve/enteve kontraktore

Operatorëve ekonomikë

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP"), njofton të gjithë palët e interesuara se:

Në kuadër të ndryshimeve ligjore që janë bërë së fundmi në legjislacionin e prokurimit publik, sikurse janë ndryshimet në Ligjin 162/2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar dhe në VKM 285/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar, janë hartuar ndryshime në setet e Dokumentave Standarde të Tenderit (në vijim "DST"), për mallra, punë shërbime, për të gjitha llojet e procedurave të prokurimit të miratuara sipas vendimeve përkatëse të APP, me qëllim reflektimin e këtyre ndryshimeve.

Me qëllim njohjen me DST e reja të miratuara për mallra, punë, shërbime **për procedurat e prokurimit "E hapur", "E Hapur e Thjeshtuar", "Tender i Kufizuar" dhe "Negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës"**, sjellim në vëmendje se, setet përkatëse publikohen sot, në datë 23.09.2024 në Faqen Zyrtare të APP, në seksionin "Legjislacioni"- "Prokurimi Publik"- "Dokumentat Standarte të Tenderit" dhe **hyjnë në fuqi në datë 26.9.2024 sipas vendimet përkatëse.**

Ndërkohë, APP po vijon punën edhe për miratimin e seteve të DST, për procedurat e tjera të prokurimit.

Disa nga ndryshimet, që sjellin DST e miratuara, janë si më poshtë:

- Shfuqizimi i setit të DST "Shërbim Konsulence",
- Rishikimi i Formularit të Njoftimit të Kontratës,
- Rishikimi i Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë,
- Rishikimi i Formularit Përmbledhës i Vetëdeklarimit, për të ardhur në një linjë me parashikimet ligjore të miratuara me ligjin nr. 16/2024, dhe VKM 498/2024, si dhe rishikimi i Formularit të Dorëzimit të Ofertës së Pavarur;
- Rishikimi i Formularit të Ofertës Ekonomike, e cila përdoret në rastin e procedurave të prokurimit për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, kur aplikohet si kriter vlerësimi oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmimin më të ulët nga operatori ekonomik,

- Rishikimi Listës së Cmimeve të Shërbimeve,
- Rishikimi i Formularëve të Njoftimit të Fituesit, si dhe formularëve që përdoren në rastin e prokurimit nëpërmjet marrëveshjes kuadër,
- Rishikimi i Formularit të Kontratës së nënshkruar, shtojca e shkurtuar që publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike
- Rishikimi i Formularit të Anulimit të procedurës së prokurimit.

Duke ju falënderuar,

**DREJTORI PËRGJITHSHËM**

**Reida Kashta**

